



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE PËR NDIHMË TË MENJËHERS DHE
PËR RIPARIM BANESASH**

Nr. 9610 Prot

Fier, më 23.07.2026

Projekt -Vendim

Nr. 76, datë 23.07.2026

"Për përcaktimin dhe miratimin e kriterëve, vlerës dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë familjet në nevojë që kërkojnë të trajtohen me ndihmë të menjëhershme financiare"

Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 54, gërma "k". Ligjin Nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale", Ligji 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, Ligji nr.68, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.118, datë 11.12.2025. "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028, si dhe Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2026", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.14, datë 28.01.2026 "Për Ngritjen e Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndhimë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash", pranë Bashkisë Fier", i ndryshuar me VKB nr.37 datë 31.03.2026, "Për një Ndryshim në VKB- nr 14, datë 28.01.2026 "Për Ngritjen e Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndhimë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier", në Urdhrin nr.423, datë 13.07.2026 "Për Përcaktimin e anëtarëve të administratës së Bashkisë Fier në Komisionin për Trajtimin e Kërkesave për Ndhimë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash" si dhe mbështetur në detyrat e përcaktuara në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi,

Propozon:

1. Miratimin e kriterëve, vlerës dhe dokumentacionin për trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave për përfitimin e ndihmës së menjëhershme, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Vlera financiare për ndihmë të menjëhershme për cdo familje aplikuese që plotëson kriteret për të përfituar nuk mund të tejkalojë 200.000 (dyqind mijë) lekë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhet dhe Kontabilitet.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Zv/Kryetare ; Mirela Pitushi

Dr.Juridike; Esmeralda Kapllanaj

Dr. Financë, Buxhet dhe Kontabilitet; Pranvera Çina

Kryetar

ARMANDO SUBASHI

